

RELACION TEKNIK PER PUNIMET ELEKTRIKE

Projekti Elektrik Shkolla "Muhamet Gjollesha" me vendodhje në Lazarat, Gjirokastrë

Në projektin elektrik përcaktohet furnizimi me energji elektrike nga OSHEE, e llogaritur kjo nga ngarkesa elektrike e objektit duke përfshirë dhe rezervat e mundshme të llogaritura në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi i daljeve elektrike	Kati i dytë	Kati i parë	Kati përdhe	Nd. jashtëm	Pompa	Të tjera	
Ngarkesa e llogaritur në kW	10	10	14	2.6	1.2	4.5	
Koeficienti i shfrytëzimit	0.4	0.4	0.6	0.8	0.7	0.85	
Fuqia e shfrytëzuar	4	4	8.4	2.08	0.84	3.825	23.145
					Fuqia totale		24 kW

Kërkesa për furnizimin me energji të objektit do të bëhet duke pasur parasysh këto llogaritje të ngarkesave si dhe shtesave të mundshme duke mos ditur shfrytëzimin përfundimtar të ambienteve të shërbimit pra për rreth 20 kW.

Specifikimet teknike të instalimit elektrik të përcaktuara në objekt jepen si më poshtë:

1. Instalimet elektrike të fuqisë dhe sinjalizimit që kalojnë në dyshme bëhen me tub të rëndë, kurse ato që kalojnë në mure dhe tavane janë të serisë së lehtë;
2. Projekti parashikon mbrojtjen diferenciale me rëlë diferenciale 0.03° , $R_t < 4$ dhe me mbrojtjen nga LSH automat termo-elektromagnetik 0.1;
3. Linjat e furnizimit janë me tre përcjellës (kafe=fazë, blu=nul, e verdhë=tokëzim);
4. Karakteristikat e automateve duhet të zbatohen rigorozisht sipas klasit A, B, C dhe D (karakteristika termike e momentit të inercisë) për të garantuar selektivitet;
5. Përcjellësit që do të përdoren do të jenë fleksibël antifiam;
6. Instalimi i elementëve do të bëhet si më poshtë:
 - 6.1. Lartësia e kuadrit do të jetë 1.7 m nga ± 0.00 e katit;
 - 6.2. Lartësia e çelësave do të jetë 110 cm nga ± 0.00 e katit;
 - 6.3. Lartësia e kutive shpërndarëse 25 cm nga ± 0.00 e katit;
 - 6.4. Lartësitë e prizave në ambientet e tjera 0.55 m;
 - 6.5. Prizat e bojlerit në lartësinë e daljeve të furnizimit dhe 10 cm djathtas ose majtas dhe faza e tij komandohet me çelës 0-16 A;
 - 6.6. Dalja e aspiratorit në lartësinë 1.55 m;

- 6.7. Prizat e kondicionerit në lartësinë 220 cm nga kuota ± 0.00 e katit;
- 6.8. Furnizimi i bojlerit dhe kondicionerit do të bëhen me përcjellës 4 mm (t+n+T=4 mm + 4 mm + 2 mm).
7. Kollona elektrike do të planifikohet me konstruksion me përmasa (700/50) duke lënë vrimat në kate;
 8. Kuadri tip i klasave do të jetë i tipit brenda murit me 12 module siç paraqitet në fletën përkatëse;
 9. Kuadri i pompave do të jetë i tipit jashtë murit me shkallë IP-65 dhe respektivisht 24 module, dhe do të vendohet në katin përdhe afër ambientit teknik;
 10. Kuadrot e kateve do të jenë 36 module dhe furnizimi i tyre do të jetë me linjë trefazore nga boksi i veçantë;
 11. Kuadri elektrik i matjes do të jenë tip boksi dhe do të kenë matësin trefazë. Kuadri trefazor do të ketë 1 matës trefazor për pompat dhe ndriçimin e shkallëve;
 12. Rezistenca e tokëzimit pas matjes të jetë më e vogël ose baraz 2 om, që mund të realizohet duke shtuar elektrodën e tokëzimit;
 13. Ndriçimi i shkallëve do të bëhet me finder i komanduar në çdo kat;
 14. Në çdo kat do të vendosen zile elektrike që do të komandohen nga salla e mësuesve ose sekretaria;
 15. Kolonat e kateve do të instalohen me kabëll FR-OR, 3x10 mm² (F+N+T);
 16. Kablli i telefonisë do të jetë UTP cat 5e, kurse kablli i rrjetit LAN do të jetë FTP cat 6e;
 17. Do të vendoset 1 kasetë hyrëse, në anën e jashtme të godinës dhe që furnizohen me kabëll 4x35 mm² nga siguresa - 100 A, furnizimi i të cilit do të bëhet me urë nga bokset e para;
 18. Shiriti i tokëzimit dhe rrufepritësit do të jetë material zinku (Zn shufër 25x4 mm). Konturet rrethues të rrufepritësit në katin e sipërm do të ketë elektroda me majë (Zn) me gjatësi 50 cm dhe distancë ndërmjet tyre 75 cm. Konturi i poshtëm përfundon në zbritje me elektroda Zn me l=1.5 m dhe shiriti lidhës i elektrodave dhe shiriti lidhës i elektrodave mbyll konturin e poshtëm, i cili ndodhet 2 m jashtë objektit ku pika e fundit shkarkon në elektrodën e fundit 10 m larg objektit. Gropat e elektrodave mbushen me kripë, qymyr, tallash çdo 20 cm;
 19. Do të respektohet një skemë tokëzimi siç paraqitet në fletën përkatëse për çdo seksion duke mos patur lidhje me atë të seksionit tjetër për të patur rezultat më të mirë në vlerën e rezistencës së tokëzimit;
 20. Kollonat e sinjaleve (LAN, telefoni dhe sinjalizimi i zjarrit) të paraqitura në fletët përkatëse do të jenë të veçanta;
 21. Linjat nga kutia qendrore shpërndarëse në kutitë shpërndarëse të ambienteve do të futen në tuba të rëndë, pa xhuntime rrugës;
 22. V.O.: Shenjat konvencionale jepen në fletët përkatëse.

Hartuar nga:

Technical Planning Development Group

Shtator 2023